

31995L0050

Direktivë e Këshillit 95/50/KE e 6 tetorit 1995 mbi procedurat e njëjtësuarra për kontrollet në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme

Gazeta Zyrtare L 249, 17/10/1995, fq. 0035-0040

Direktivë e Këshillit 95/50/KE e 6 tetorit 1995 mbi procedurat e njëjtësuarra për kontrollet në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme

Këshilli i Bashkimit Europian,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian, në veçanti nenin 75 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin nga Komisioni [1];

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social [2];

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 189c të Traktatit [3];

Duke pasur parasysh se Komuniteti ka miratuar një sërë masash për krijimin e një tregu të brendshëm, që sjell formimin e një hapësire pa kufij të brendshëm, që garanton qarkullimin e lirë të mallrave, të personave, të shërbimeve dhe kapitalit, në përputhje me dispozitat e traktatit;

Duke pasur parasysh se kontrollet mbi transportin rrugor të mallrave të rrezikshme kryhen në përputhje me Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 4060/89 të 21 dhjetorit 1989, lidhur me eliminimin e kontrolleve të kryera në kufijtë e Shteteve Anëtare në fushën e transportit rrugor dhe nëpërmjet lumenjve të lundrueshëm[4], dhe të Rregullores së Këshillit (KEE) nr. 3912/92 të 17 dhjetorit 1992, lidhur me kontrollet e kryera në brendësi të Komunitetit në sektorët e transporteve rrugore dhe nëpërmjet lumenjve të lundrueshëm, në lidhje me mjetet e transportit të regjistruara ose të vëna në qarkullim në një vend të tretë [5];

Duke pasur parasysh se Këshilli ka miratuar Direktivën 94/55/KE e 21 nëntorit 1994, për përafrimin e legjislacioneve të Shteteve Anëtare lidhur me transportin rrugor të mallrave të rrezikshme [6]; duke pasur parasysh se procedurat përkatëse për kontrollin dhe përkufizimin në lidhje me këtë lloj transporti duhet të harmonizohen në mënyrë të njëjtë, me qëllim që përputhja me standardet e sigurisë të përcaktuara në këtë direktivë të vërtetohet në mënyrë më të efektshme.

Duke pasur parasysh se Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë një nivel të mjaftueshëm të kontrolleve për mjetet që kanë lidhje gjatë gjithë territorit të tyre, ndërsa ku të jetë e mundur, mënjanimin e shtimit të kontrolleve të tilla. Duke pasur parasysh se, duke marrë shkas nga parimi i subsidiaritetit, është i nevojshëm veprimi i Komunitetit për përmirësimin e nivelit të sigurisë së transportit të mallrave të rrezikshme;

Duke pasur parasysh se kontrollet kryhen duke përdorur një listë të elementeve të përbashkët, të zbatueshme për këto transporte në të gjithë Komunitetin;

Duke pasur parasysh se është i nevojshëm hartimi i një liste për shkelje të konsideruara mjaft të rënda nga Shtetet Anëtare, sa të sjellin si pasojë zbatimin e masave të përshtatshme në varësi të rrethanave ose të kërkesave të sigurisë mbi mjetet në fjalë, duke përfshirë kur është e përshtatshme, refuzimin për të pranuar mjete të tilla në territorin e Komunitetit;

Duke pasur parasysh se, për të përmirësuar zbatimin e normave të sigurisë së transportit rrugor të mallrave të rrezikshme, nevojitet parashikimi i kontrollit të ndërmarrjeve si një masë parandaluese, ose kur janë konstatuar në rrugë shkelje të rënda të legjislacionit për transportin e mallrave të rrezikshme;

Duke pasur parasysh se kontrollet në fjalë duhet të shtrihen në të gjitha dërgesat rrugore të mallrave të rrezikshme, të transportuara tërësisht ose pjesërisht brenda territorit të Shteteve Anëtare, pavarësisht nga vendi i nisjes ose i mbërritjes së mallrave ose nga vendi i regjistrimit të mjetit;

Duke pasur parasysh se, në rast të shkeljeve të rënda ose të përsëritura, mund të kërkohet nga autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare ku është regjistruar mjeti ose ku është e regjistruar ndërmarrja, duhet të merren masa të përshtatshme, dhe duke pasur parasysh se ata duhet të vënë në dijeni Shtetin Anëtar që paraqet kërkesën mbi çdo masë të marrë në vazhdim;

Duke pasur parasysh se zbatimi i kësaj direktive duhet të jetë i vëzhguar mbi bazën e një raporti të paraqitur nga Komisioni,

KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

Neni 1

1. Kjo direktivë zbatohet për kontrollet e kryera nga Shtetet Anëtare mbi transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, në mjetet që qarkullojnë në territorin e tyre ose që hyjnë nga një vend i tretë.

Kjo nuk zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme të kryera nga mjetet që i përkasin ose janë nën përgjegjësinë e forcave të armatosura.

2. Kjo direktivë nuk prek gjithsesi të drejtën e Shteteve Anëtare, në zbatim të së drejtës Komunitare, të kryejnë kontroll mbi transportet kombëtare dhe ndërkombëtare të mallrave të rrezikshme në territorin e tyre, nga mjete që nuk mbulohen nga kjo direktivë.

Neni 2

Për qëllimet e kësaj direktive:

- “mjet” nënkupton çdo lloj mjeti motorik, i plotë ose jo, i destinuar të qarkullojë në rrugë, pajisur me të paktën katër rrota dhe që ka një shpejtësi maksimale të planifikuar mbi 25 km/h, së bashku me rimorkiot, me përjashtim të makinave që lëvizin mbi binarë, traktorët bujqësorë dhe pyjorë dhe çdo lloj tjetër makine e lëvizshme;
- “mallra të rrezikshme” nënkupton mallra të rrezikshme të përkufizuara si të tilla nga Direktiva 94/55/KE;
- “transport” nënkupton çdo lloj veprimi transporti rrugor i kryer tërësisht ose pjesërisht nga një mjet, në rrugët publike brenda territorit të një Shteti Anëtar, përfshirë veprimet e ngarkimit dhe të shkarkimit të përfshira në direktivën 94/55/KE, pa cenuar rregullimet e përcaktuara nga legjislacioni i Shteteve Anëtare në lidhje me përgjegjësitë që rrjedhin nga këto veprime,
- “ndërmarrje” nënkupton çdo person fizik ose juridik, me ose pa qëllim përfitimi, çdo lloj shoqërie ose grup personash pa personalitet juridik, me ose pa qëllim përfitimi, dhe çdo organ që ndodhet nën autoritetin publik, qoftë kur vet ka personalitet juridik ose është nën varësi të një autoriteti me personalitet të tillë, i cili transporton, ngarkon, ose shkarkon mallra të rrezikshme, por edhe ata që magazinonjë përkohësisht, mbledhin, paketojnë ose marrin këto mallra përgjatë një veprimi të transportit dhe që janë të vendosura në territorin e Komunitetit,

- “kontroll” nënkupton çdo verifikim, kontroll, inspektim, vërtetim ose formalitet të kryer nga autoritetet kompetente për arsye të sigurisë që lidhet me transportin e mallrave të rrezikshme.

Neni 3

1. Shtetet Anëtare sigurohen që një raport përfaqësues i dërgesave rrugore të mallrave të rrezikshme të transportuara t’i nënshtrohet kontrolleve të parashikuara nga kjo direktivë për të vërtetuar përputhshmërinë e tyre me legjislacionin mbi transportin rrugor të mallrave të rrezikshme.
2. Këto kontrolle do të kryhen në territorin e një Shteti Anëtar në përputhje me nenin 3 të Rregullores (KEE) nr. 4060/89 dhe nenin 1 të Rregullores (KEE) nr. 3912/92.

Neni 4

1. Për të kryer kontrollet e parashikuara në këtë direktivë, Shtetet Anëtare përdorin listën e kontrolleve në Shtojcën I. Një kopje e kësaj liste ose një certifikatë që vërteton rezultatin e kontrollit, i hartuar nga autoriteti që ka kryer kontrollin, duhet t’i dorëzohet drejtuesit të mjetit dhe të paraqitet me kërkesë për të thjeshtuar ose shmangur, kur është e mundur, kontrolle të mëtejshme. Ky paragraf nuk cenon të drejtën e Shteteve Anëtare të marrin masa të veçanta për kontrolle të hollësishme.
2. Kontrollet do të jenë të rastësishme dhe do të mbulojnë, sa më shumë të jetë e mundur, një pjesë të madhe të rrjetit rrugor.
3. Vendet e zgjedhura për këto kontrolle duhet të lejojnë mjetet shkelëse të vihen në përputhje me rregullat, ose atëherë kur autoriteti që ndjek kontrollin e quan të arsyeshme, t’i bllokojë në vend ose në një vend të caktuar posaçërisht nga ky autoritet pa vënë në rrezik sigurinë.
4. Nëse është e nevojshme, dhe me kusht që kjo të mos përbëjë një rrezik për sigurinë, kampione të mallrave të transportuara mund të merren për t’u studiuar nga laboratorë të njohur nga autoriteti kompetent.
5. Kontrollet nuk duhet të kalojnë një kohëzgjatje të arsyeshme.

Neni 5

Pa cenuar ndëshkime të tjera që mund të vendosen, mjetet në lidhje me të cilat janë konstatuar një ose më shumë shkelje të rregullave të transportit të mallrave të rrezikshme, në veçanti shkeljet e renditura në Shtojcën II, mund të bllokohen në vend ose në një shesh të caktuar për këtë qëllim nga autoritetet që kryejnë kontrollin, dhe janë të urdhëruar të vihen në rregull para se të vazhdojë udhëtimi, ose mund të jenë objekt i masave të tjera në varësi të rrethanave ose kërkesave të sigurisë, duke përfshirë, atëherë kur është e përshtatshme, refuzimin e hyrjes së këtyre mjeteve në territorin e Komunitetit.

Neni 6

1. Kontrolle mund të bëhen edhe në mjediset e ndërmarrjeve, si masë parandaluese ose kur në rrugë janë regjistruar shkelje të cilat rrezikojnë sigurinë në transportin e mallrave të rrezikshme.
2. Qëllimi i këtyre kontrolleve është të garantojë që kushtet e sigurisë në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme të jenë në përputhje me legjislacionin përkatës.

Nëse vërehet një ose më shumë shkelje, në veçanti ato të përmendura në Shtojcën II, në lidhje me transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, transporti në fjalë duhet të vijë në përputhje me rregullat përpara daljes nga ndërmarrja, në rast të kundërt i nënshtrohet masave të tjera të përshtatshme.

Neni 7

1. Shtetet Anëtare ndihmojnë njëri-tjetrin me qëllim që kjo direktivë të arrijë efektin e duhur.
2. Shkeljet e rënda ose të përsëritura që rrezikojnë sigurinë e transportit të mallrave të rrezikshme, të kryera nga një mjet ose nga një ndërmarrje jorezidente, duhet t'i njoftohen autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar në të cilin mjete është regjistruar ose në të cilin ndërmarrja është themeluar.

Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar në të cilin është konstatuar një shkelje e rëndë ose e përsëritur, mund të kërkojnë nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar, në të cilin mjete është regjistruar ose në të cilin është vendosur ndërmarrja, që të merren masat e duhura në ngarkim të shkelësit ose të shkelësve.

Autoritetet kompetente të fundit duhet të njoftojnë autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar në të cilin janë regjistruar shkeljet e masave të marra në ngarkim të transportuesit ose ndërmarrjes.

Neni 8

Nëse, në rast të kontrollit rrugor të një makine të regjistruar në një Shtet tjetër Anëtar, konstatimet e bëra lënë të kuptosh që janë kryer shkelje të rënda ose të përsëritura të pashaqura gjatë kontrollit, për mungesë të elementeve të nevojshëm, autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të interesuara premtojnë ndihmë reciproke për të sqaruar situatën. Në rastin në të cilin Shteti Anëtar kompetent kryen, me këtë objekt, një kontroll në ndërmarrje, rezultatet e këtij kontrolli i bëhen të njohura Shtetit tjetër Anëtar të interesuar.

Neni 9

1. Për çdo vit kalendarik, jo më vonë se dymbëdhjetë muaj nga përfundimi i këtij të fundit, çdo Shtet Anëtar i dërgon Komisionit, një raport të hartuar në përputhje me modelin në Shtojcën III, mbi zbatimin e kësaj direktive, duke përfshirë të dhënat e mëposhtme:
 - nëse është e mundur, volumin e përcaktuar ose të vlerësuar të transportit rrugor të mallrave të rrezikshme (në tonelata të transportuara ose në tonelata/kilometra);
 - numrin e kontrolleve të kryera;
 - numrin e mjeteve të kontrolluara, sipas vendit të regjistrimit (mjete të regjistruara në territorin kombëtar, të Shteteve të tjera Anëtare ose të vendeve të treta);
 - numrin dhe llojet e shkeljeve të regjistruara;
 - llojin dhe numrin e sanksioneve të vendosura.
2. Për herë të parë në vitin 1999 dhe më pas për të paktën çdo tre vjet, Komisioni i dërgon Parlamentit Europian dhe Këshillit një raport mbi zbatimin e kësaj direktive nga Shtetet Anëtare, duke deklaruar të dhënat në përputhje me paragrafin 1 më lart.

Neni 10

1. Shtetet Anëtare miratojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me këtë direktivë brenda 1 janarit 1997. Ato informojnë menjëherë Komisionin.

Kur Shtetet Anëtare miratojnë këto dispozita, ato do të përmbajnë një referim në këtë direktivë ose do të shoqërohen nga një referim i tillë në rastin e botimit të tyre zyrtar. Mënyrat e realizimit të kësaj reference do të përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të së drejtës së brendshme që ata miratojnë në fushën që rregullohet nga kjo direktivë.

Neni 11

Kjo direktivë hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 12

Kjo direktivë i adresohet Shteteve Anëtare.

Hartuar në Luksemburg, më 6 tetor 1995.

Për Këshillin

Presidenti

J. Borrell Fontelles

(1) GZ C 26 e 29.01.1994, fq. 10 dhe GZ C 238, datë 26.08.1994, fq. 4.

(2) GZ C 195, datë 18.07.1994, fq. 18.

(3) Mendim i Parlamentit Europian, datë 3 maj 1994 (GZ C 205, datë 25.7.1994, fq. 55). Mendim i Përbashkët i Këshillit, datë 21 nëntor 1994 (GZ C 354, datë 13.12.1994, fq. 1) dhe Vendim i Parlamentit Europian, datë 14 mars 1995, (GZ C 89, datë 10.04.1995, fq. 29).

(4) GZ L 390, datë 30.12.1989, fq. 18. Rregullore e ndryshuar nga Rregullorja (KEE) nr. 3356/91 (GZ L 318, datë 20.11.1991, fq. 1).

(5) GZ L 395, datë 31.12.1992, fq. 6.

(6) GZ L 319, datë 12.12.1994, fq. 7.

SHTOJCA I
Lista e plotë

1. Vendi i kontrollit 2. Data 3. Ora
4. Shenja dalluese kombëtare dhe nr. i regjistrimit 5. Shenja dalluese kombëtare dhe nr. regjistrimit të rimorkios/gjysmë-rimorkios
6. Tipi i makinës kamion tërheqës me rimorkio mjete të lidhura me platformë
7. Ndërmarrja që kryen transportin/adresa
..... 8. Kombësia
9. Drejtuesi
10. ►¹ Ndhmës drejtuesi ◀
11. Dërguesi, adresa, vendi i ngarkimit¹
.....
12. Marrësi, adresa, vendi i shkarkimit¹
.....
13. ►² Sasia e përgjithshme e mallrave të rrezikshme për njësi transporti ◀
.....
14. Kufijtë e sasive të vendosura nga zëri 10 011 të kaluara po jo
15. Kryer përmes:
 cisternave fikse cisternave të lëvizshme konteiner-cisternë ►³ konteiner vetëshkarkues ◀
 pa rregull (rifuxhio) konteiner koli

Dokument/e të rëndësishme

16. Dokument/e të transportit/të shoqërimit kontrolluar konstatuar shkelje nuk nevojitet
17. Udhëzime të shkruara kontrolluar konstatuar shkelje nuk nevojitet
18. Marrëveshje dypalëshe/shumëpalëshe/autorizim kombëtar kontrolluar konstatuar shkelje nuk nevojitet
19. Vërtetim i homologimit të mjetit kontrolluar konstatuar shkelje nuk nevojitet
20. Vërtetim i formimit të drejtuesit kontrolluar konstatuar shkelje nuk nevojitet

Qarkullimi i mjetit

¹ Për t'u saktësuar zëri "shënime" për transporte grumbull

►¹ **C1**

►² **M1**

►³ **M1**

21. Mall i autorizuar për transport	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet
22. Transport me mall hedhur pa rregull (rifuxhio)	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet
23. Transport në cisterna	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet
24. Transport në konteiner	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet
25. Mall i autorizuar sipas tipit të makinës	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet
26. Ndalimi i ngarkesave të përziera	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet
27. Mbajtje dhe magazinime ²	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet
28. Rrjedhje të mallit ose dëmtime të kolisë ²	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet
29. Numri OKB/Etiketimi i kolisë/kodi i ambalazhit OKB (¹)(²)	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet
30. Sinjalistika e makinave dhe/ose konteinerëve	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet
31. Etiketa/at e rrezikut të transportit cisternë ose rifuxhio	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet

Pajisjet e makinës

32. ► ¹ Kuti veglash për riparime të shpejta ◀	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet
33. Të paktën një pykë (kunj) për makinë	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet
34. ► ² Dy sinjale të rrezikut të vetëtransportueshme ◀	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet
35. Fikës/a zjarri	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet
36. ► ³ Një xhup i përshtatshëm ose veshje sinjalizuese për secilin anëtar të ekuipazhit të makinës ◀	<input type="checkbox"/> kontrolluar	<input type="checkbox"/> konstatuar shkelje	<input type="checkbox"/> nuk nevojitet

37. Të ndryshme/Shënime

38. Autoriteti që ka kryer kontrollin

SHTOJCA II

Shkeljet

Për qëllimet e kësaj direktive, konsiderohen si shkelje, në veçanti, këto raste:

² Kontroll i shkeljeve të dukshme

¹ Për t'u saktësuar zëri "shënime" për transporte grumbull

►^{1 2 3} **M1**

- 1) mall i paautorizuar për transport;
- 2) mungesë e deklaramit të dërguesit mbi përputhshmërinë e mallrave dhe ambalazhit me rregulloret e transportit;
- 3) mjete që paraqesin gjatë kontrollit rrjedhje të mallrave të rrezikshme si pasojë e mungesës së garantueshmërisë së mosrrjedhjes së cisternave ose të kolive;
- 4) mjete të papajisura me certifikatën ose homologen, ose të pajisura me certifikatë jo të rregullt;
- 5) mjete të papajisura me panele portokalli të duhura ose të përshtatura me panele portokalli të parregullta;
- 6) mjete pa udhëzimet e sigurisë ose udhëzime të sigurisë të papërshtatshme;
- 7) mjet ose ambalazh i papërshtatshëm;
- 8) drejtues pa certifikatë të rregullt të formimit për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme;
- 9) mjete të papajisura me fikës zjarri;
- 10) mjete ose koli të papajisura me etiketa të rregullta që tregojnë rrezikun;
- 11) mjete të papajisura me dokumente transporti/shoqëruese ose tabelën përkatëse për mallra të rrezikshme të transportuara në mospërputhje me rregulloret;
- 12) mjete të papajisura me marrëveshjen dypalëshe/shumëpalëshe ose marrëveshje të parregullt;
- 13) tejkalim i mbushjes së cisternës.

SHTOJCA III

Modeli i formularit standard për raportin që do t'i dërgohet Komisionit në lidhje me shkeljet dhe sanksionet

Shteti Viti

Kontrolle të kryera në rrugë

	Makina të regjistruara në territor ¹			
	Kombëtare	Të Shteteve të tjera Anëtare të BE	Të vendeve të treta	Numri i përgjithshëm
Numri i makinave të kontrolluara				
Numri i shkeljeve të konstatuara sipas llojeve të shkeljeve				
Numri dhe lloji i sanksioneve të vendosura				

¹ Për qëllimin e kësaj shtojce vendi i regjistrimit është ai i mjetit motorik